

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE  
DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROCEDURËS:**

“Blerje pulla kontrolli me elementë sigurie për barnat, dhe aksesori për shtypjen e tyre” për mbulimin e nevojave për një periudhë 24muaj, Procedurë e Hapur– Mallra – Prokurim me mjete elektronike, Marrëveshje Kuadër me 1(një) operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara.

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

*Blerje pulla kontrolli me elementë sigurie për barnat, dhe aksesori për shtypjen e tyre* **22410000-7**

**VLERA E FONDIT LIMIT:**

Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: **26,299,000** (njëzetë e gjashtë milion e dyqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë) Lekë pa TVSH.

Përllogaritja e Fondit Limit është bërë nga grupi i punës i ngritur për këtë qëllim, bazuar në Nenin 76, pika 1/c ku përcaktohet se: “1.Në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura, si më poshtë vijon: [...] c) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe[...]”-.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, të nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM Nr.285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, Tiranë** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

**a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës I;**

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos sipas nenit 29 të VKM Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik“ të ndryshuar, në të cilën është parashikuar se: *1.Oferta ekonomike përmban vlerën ekonomike pa TVSH.*

*2. Operatori ekonomik duhet të hartojë në mënyrë të pavarur, ofertën ekonomike.*

b. Lista e çmimeve të artikujve, sipas Shtojcës 2:

**Argumentimi:** Kjo shtojcë është pjesë e setit të dokumenteve standarte të tenderit për procedurën e prokurimit të sipërcituar.

c. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8:

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos bazuar në nenin 76 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik“, dhe nenin 26 të VKM Nr.285, datë 19.5.2021 ”Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.”.

d. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3:

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos bazuar në nenin 83 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik“ ku përcaktohet se: *Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël. Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit: a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlllogaritur të kontratës; b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, dhe në nenin 26 të VKM Nr.285, datë 19.5.2021 ”Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar.*

**Afati për dorëzimin/hapjen e ofertave:** 21/2/2024, ora 10.00

**Argumentimi:** Në përputhje me parashikimet e Nenit 42, pika 5, të LPP **ku përcaktohet shprehimisht se:**

*“5.Për procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të ulët dhe të lartë monetar, afati për pranimin e ofertave është jo më pak se 20 ditë nga shpallja e njoftimit të kontratës dhe, në rast se ofertat paraqiten me mjete elektronike, ky afat mund të shkurtohet me 5 ditë.”-;* dhe,

në kushtet kur fondi limit i procedurës së prokurimit është *ndërmjet kufirit të ulët dhe të lartë monetar*, procesi i emetimit të pullës së kontrollit është detyrim ligjor që rrjedh drejtëpërsëdrejti nga Neni 20 i Ligjit Nr.105/2014 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik” të ndryshuar dhe procedura e prokurimit bëhet me mjete elektronike (SPE), **afati për pranimin e ofertave u shkurtua me 5-ditë.**

## **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Certifikatën:

a) **ISO 9001** - “Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë”;

b) **ISO 14298** – “Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë së Procesit të Printimit në Teknologjinë Grafike”-;

\*Për të konfirmuar një nivel të besueshëm për elementet vizuale, elementet e sigurisë, grafikën specifike dhe refleksin e ngjyrave identifikuese që dallohen me sy të lirë ose me pajisje ndihmëse.

Certifikatat duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombetare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

**Certifikata duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.**

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos bazuar në pikën 1 të nenit 79 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik“, ku përcaktohet se: *1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.*

Ky kriter gjen mbështetje dhe në pikën 1 të nenit 44 të VKM Nr.285, datë 19.5.2021 ”Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se: *1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.*

Gjithashtu ky kriter gjen mbështetje dhe në rekomandimin e APP dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit Nr.Prot.3330, datë 20.3.2018 dhe Nr.Prot.145, datë 16.3.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kërkesave të cilësisë”.

## **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

- Kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuara nga operatori ekonomik në 3 (tre) vitet e fundit financiare (2020, 2021, 2022) ku vlera e tyre të jetë **sa vlera e fondit limit.**

*\*Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale të vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.*

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 3 të nenit 77 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik“, ku përcaktohet se: *3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës...], sikurse dhe në pikën 1 dhe pikën 2/c të nenit 43 të VKM Nr.285, datë 19.5.2021 ”Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se:*

Pika 1: “Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.”-

Pika 2/b: “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë **nuk mund të tejkalojë: vlerën e përlogaritur të kontratës** ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar”.

Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijimin e bindjes tek Autoriteti Kontraktor për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara se zotërojnë kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën siç është parashikuar nga AK.

### **Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:**

Në pikën 1 dhe në pikën 2 të nenit 43 të VKM Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, është parashikuar marzhi maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohet në Procedurën e Hapur, ku përcaktohet shprehimisht se: Pika 2/c: “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë **nuk mund të tejkalojë: vlerën e përlogaritur të kontratës** ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar”- .

Bazuar në vlerën e fondit limit të përlogaritur për këtë prokurim që është ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar (bazuar në nenin 11, pika 1, gërma a) dhe b) të RPP-së) ky kriter u vendos në përputhje të plotë me marzhin maksimal të përcaktuar për këtë lloj procedure prokurimi (ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar) në rregullat e prokurimit publik.

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënljigjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

**Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e kopjeve të deklaratave të xhiros vjetore** është bërë bazuar në nenin 43, të VKM 285/2021 “Mbi Rregullat e Prokurimit Publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3(tre) vitet e fundit financiare;”-

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e kopjeve të deklaratave të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin Nr.9920, datë 19.5.2008 ”Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nënljigjore në zbatim të tij.

*(Tatimpaguesi me mbylljen e vitit kalendarik, përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave. Formulari i Deklaratës e Pagesës së Tatimit mbi Fitimin dorëzohet në organet tatimore brenda datës 31 Mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij).*

### **2.3 Kapaciteti teknik:**

- a) Dëshmi nga operatori ekonomik për furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë jo më të madhe se **40% të vlerës së përlogaritur të kontratës**, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga **data e shpalljes së njoftimit të kontratës**
- Si dëshmi për përvojën e mëparshme me një ent publik, kërkohen vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos në përputhje me pikën 4 të nenit 77 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik“, ku përcaktohet se: *“Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës...;* si dhe me pikën 4 të nenit 40 të VKM Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se: [...] 4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.”-

#### **Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:**

Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijimin e bindjes tek Autoriteti Kontraktor për aftësinë të OE ofertues, nëpërmjet përvojave të duhura, që janë në përpjestim me natyrën e objektit të prokurimit dhe që ka aftësinë e duhur për zbatimin e kontratës siç është parashikuar nga AK.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën **40 %** të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

- b) Operatori ekonomik ofertues për mallrat objekt prokurimi (në rast se nuk është prodhues i mirfilltë) duhet të paraqesë **Autorizim nga Prodhuesi** ose nga **Distributori Zyrtar i Autorizuar nga Prodhuesi**. Autorizimi duhet të jetë i vlefshëm në momentin e hapjes dhe dorëzimit të ofertave, origjinal/fotokopje e noterizuar, e përkthyer në gjuhën shqipe dhe e noterizuar.

Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit/distributorit zyrtar të autorizuar nga prodhuesi si: telefon, fax, e-mail, website, ne se lind nevoja për verifikim nga ana e Autoritetin Kontraktor.

**Shënim:** Kriterin e mësipërm, ofertuesit mund ta përmbushin edhe në formë vetëdeklarimi, me kusht që në rastin e renditjes i pari, me njoftimin e paraqitjes së dokumentacionit pranë AK dhe përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentet provuese për deklarimin e bërë. Mosparaqitja e këtij

dokumentacioni përbën kusht për skualifikimin e ofertës së paraqitur. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

**Argumentimi:** Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, dhe pikën 6, të nenit 40, të VKM Nr.285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar.

Autorizimi për OE ofertues nga firma prodhuese ose nga distributori zyrtar i autorizuar prej prodhuesit është një dokument i domosdoshëm për t’u paraqitur, pasi përveçse siguron origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, ai garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Ky kriter është jo diskriminues, në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE për përmbushjen me sukses të kontratës. Domosdoshmëria e tij lidhet me garancinë e mallit të cilën e jep prodhuesi dhe jo operatori ekonomik ofertues.

Gjithashtu ky kriter u vendos në mbështetje të Rekomandimit Nr.Prot. 3341/1, datë 20.3.2018 të Agjencisë së Prokurimit Publik (Drejtoria Juridike dhe Monitorimit) drejtuar Autoriteteve Kontraktore “*Rekomandim mbi hartimin e kriterëve për kualifikim në dokumentet e tenderit të procedurave të prokurimit publik*”.

c) Operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë mostra të mallrave objekt prokurimi - për secilin nga artikujt e listës, sipas specifikimeve teknike të dokumenteve standarde të tenderit.

- Rulon me jo më pak se 200 pulla në rulon - 1(një) copë;
- Shirit stampimi termik - 1(një) copë  
*\*të mjaftueshme për të realizuar stampimin e plotë të rulonit me 200 pulla;*
- Rulon kartoni mbledhës për pulla - 1(një) copë;
- Rulon kartoni mbledhës për shirit printimi - 1(një) copë.

❖ Autoriteti Kontraktor kërkon mostra të mallrave që do të prokurohen, pasi gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Mostrat e mallrave do të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe do të jenë ekskluzivisht në kontroll të Autoritetit Kontraktor.

Mostrat do të dorëzohen nga OE ofertues, në Zyrën e Protokollit të AKBPM, Kati i Parë, në adresën: Rruga e Dibrës, Nr.359/1, Tiranë, të futur në një zarf jo-transparent, të mbyllur, të vulosur dhe firmosur me emrin dhe adresën e OE ofertues dhe me shënimin: “*Ofertë për furnizimin e “Blerje pulla kontrolli me elemente sigurie për barna dhe aksesore për shtypjen e tyre”, Nr e Njoftimit, “MOS E HAPNI, ME PËRJASHTIM TË RASTEVE KUR ËSHTË I PRANISHËN KOMISIONI I VLERËSIMIT TË OFERTËS, DHE JO PARA datës: 21/2/2024, ora: 10.00”.*

**Mos paraqitja e këtyre kampioneve apo mospërputhshmëria e tyre me specifikimet teknike të kerkuara në DST, në përfundim të fazës së vlerësimit teknik, përbën kusht skualifikimi.**

**Argumentimi:** Këto kriterë janë vendosur me qëllim që të identifikohet përmbushja e specifikimeve teknike për artikujt e kërkuar, dhe në përputhje me nenin 4, pika 38/b, nenin 36, nenin 77 të Ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, dhe me pikën 6/a të nenit 40 të VKM Nr.285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se:

[...] 6. Autoriteti/enti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: **a. mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike.** Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat.

Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces.

Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose [...].

## II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

### Shtojca 5. "FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE"

#### ▪ *PULLA KONTROLLI ME ELEMENTË SIGURIE:*

#### **Përshkrimi i të dhënave teknike të mallrave objekt prokurimi:**

Skicimet, parametrat teknik etj; Specifikimi i Materialeve; Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to janë si më poshtë vijon:

#### 1- Artikulli: **Pulla kontrolli me elementë sigurie për barna.**

**Përshkrimi:** pullat duhet të jenë të ndara nga njëra tjetra, të vendosura në qendër, distanca midis tyre 3 mm, të ngjitura në rulon letër.

*Funksionimi:* Prodhimi i pullave do të bëhet në rulon që lejon përdorimin e makinave automatike dhe manuale.

*Përmasat-*Dimensionet e etiketës janë 25 x 14.5 mm, me cepa të rrumbullakosura.

*Karakteristika të materialit përbërës:*

#### ▪ Etiqueta

Letër e bardhë pa dru e patinuar nga njëra anë me llustër. Letra të ketë sipërfaqe të shkëlqyeshme e përshtatshme për shtypje me shumë ngjyra, me precizion.

Pesha 78 gr/m<sup>2</sup>

Spesori 68 mikron

Bardhësia 90%

Opaciteti 90%

Shkëlqyeshmëria 84%

Këputja në drejtim MD e CD 8-4 kg/15 mm

#### ▪ Adezivi

Nga prapa pulla të ketë adeziv të qëndrueshëm akrilik i përshtatshëm për një gamë të gjerë të etiketave të natyrës që kërkojmë (pulla) dhe i aplikueshëm për ndryshime të mëdha të temperaturës.

Ngjitja të jetë e fortë/permanente ku në 60 minuta pas ngjitjes të jetë e pashqitshme.

Qëndrueshmëria e këputjes të jetë 480m.

Koha e aftësisë ngjitëse 1 orë minimal  
Temperatura e aplikimit +5 °C  
Variacion temperature në përdorim -20 deri në +80 °C

- Letra mbajtëse ku vendosen pullat  
Letër super kalandruar monosilikon  
Pesha 61 gr/m<sup>2</sup>  
Spesori 55 mikron  
Transparenca 49 %  
Qëndrueshmëria në këputje 80 deri në 40 N/15 mm

## **Përshkrimi:**

**I.** I gjithë sfondi i etiketës duhet të jetë me një motiv (tip filigrane mijëra pikëshe), shtypur *me ngjyrë Pantone 608C* e sfumuar nga jashtë brenda.

## **Pulla do të përfshijë të stampuar:**

- a) Në krye të saj, në sfond të shkrimit duhet të ketë: një motiv tip filigrane me valëzim me dimension 25 mm x 3 mm, me bojë UV me ngjyrë Blu Reflex e sfumuar në drejtim vertikal, si dhe shkrimin **MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE** me dimension 20 mm x 1 mm, me karakter Times New Roman (kapitale), të qendëruara, shtypur mbi motivin e valëve, me ngjyrë Blu Reflex.
- b) Në fund të saj, në sfond të shkrimit duhet të ketë: një motiv tip filigrane me valëzim me dimension 25 mm x 3 mm, me bojë UV me ngjyrë Blu Reflex e sfumuar në drejtim vertikal, si dhe shkrimin **AGJENCIA KOMBËTARE E BARNAVE DHE PAJISJEVE MJEKËSORE** me dimension 24 mm x 1 mm, me karakter Times New Roman (kapitale), të qendëruara, shtypur mbi motivin e valëve, me ngjyrë Blu Reflex.
- c) Në krahun e majtë të pullës në mënyre vertikale do të vendoset një numër 8 (tetë) shifror progresiv nga 00000001 e në rritje. Numri do të jetë me ngjyrë të zezë, lloji i shkrimit të numrit Times New Roman, gjerësia e numrit 1.2 mm dhe gjatësia 8 mm. Sipërfaqja duhet të jetë e patinuar nga njëra anë me llustër.

## **II. Elementë sigurie:**

- Në dy cepa të etiketës me koordinata: 1,5 mm x 11,5 mm dhe 23,5 mm x 11,5 mm, duhet të ketë dy elemente sigurie (*stema e farmacisë gjarpër në gotë*), me dimension 2 mm x 2 mm, shtypur me bojë të tejudkshme që fluoroshon ngjyrë të verdhë nën dritën e llampës ultravioletë.
- Në pjesën e sipërme, nën shkrimin **MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE**, duhet të ketë elementë sigurie në formë drejtkëndëshi me dimension 20 mm x 1 mm, shtypur me bojë të tejudkshme që fluoroshon ngjyrë të verdhë nën dritën e llampës ultravioletë.
- Në pjesën e poshtme, mbi shkrimin **AGJENCIA KOMBËTARE E BARNAVE DHE PAJISJEVE MJEKËSORE**, duhet të ketë elementë sigurie në formë drejtkëndëshi me dimension 20 mm x 1 mm, shtypur me bojë të tejudkshme që fluoroshon ngjyrë të verdhë nën dritën e llampës ultravioletë.



- Midis dy motiveve poshtë e lart, duhet të ketë një hapësirë bosh (sfond) me bojë UV me ngjyrën e përcaktuar si në pikën 1, prej 8mm, e mjaftueshme për të shtypur tekstin, me letër termo transfertë.

### **Ambalazhi**

Pullat duhet të jenë në rulon me përmasa: 40mm diametri i brendshëm dhe jo më e madhe se 200mm diametri i jashtëm; duhet të ketë në fund të shiritit te ngjitur në mënyrë të sigurt etiketën specifikuese, për sasinë e pullave në rulon. Të jenë të paketuara dhe të ambalazuara në kuti, në mënyrë të tillë që të jetë e përshtatshme për ruajtjen dhe mbrojtjen nga faktorë të jashtëm. Kutia nuk duhet të peshojë më shumë se 25 kg.

### **Etiketimi**

Do të përfshijë në shqip sasinë për çdo njësi ambalazhi (ruloni numrin e pullave, kuti/kolia numrin e rulonave)

- *SHIRITA STAMPIMI TERMIK:*

**Karakteristikat:** Shiriti i printimit është i standartit universal ose *ekuivalent i tij*, i përshtatshëm për printim në letër me shtresë të shkëlqyeshme (gloss coated). Për printerat që disponojmë, shiriti termo-transfertë mund të jetë i ngjashëm me tipin wax/resin.

Shiriti duhet të ketë: rezistencë të lartë kundrejt gërvishtjeve;  
tretësve të ndryshëm;  
veti stampuese shumë të mira.

Densiteti optik i shiritit 0.9 në transmetim

Densiteti optik (reflektimi) 1.70 në reflektim

### **Ambalazhi**

Shirit i stampimit të jetë i mbledhur në rulona me gjatësi minimalisht 360 m dhe gjerësi 30 mm, diametër i brendshëm i unazës së kartonit të jetë 25mm, të përdorshëm për pajisjet e printimit të tipit *Printer me transfertë termikë SQUIX*, të paketuara në kuti mënyrë të tillë që të jetë e përshtatshme për ruajtjen dhe mbrojtjen nga faktorë të jashtëm.

- *RULONA KARTONI:*

- a) për mbledhjen e pullave, me gjerësi 30 mm, diametër të brendshëm të unazës së kartonit 40mm, e përshtatshme për pajisjet e printimit të tipit *Printer me transfertë termikë SQUIX*;
- b) për mbledhjen e shiritave të printimit, me gjerësi 30 mm, diametër të brendshëm të unazës së kartonit 25mm.

### **Ambalazhi**

Të jenë të paketuara dhe të ambalazuara në kuti, në mënyrë të tillë që të jetë e përshtatshme për ruajtjen dhe mbrojtjen nga faktorë të jashtëm.

### **Etiketimi**

Do të përfshijë në shqip sasinë për çdo njësi ambalazhi (kutit/kolia numrin e rulonave).

- ❖ Bashkëlidhur specifikimeve teknike janë vendosur Modele ilustruese të pullës dhe aksesorëve për shtypjen e tyre (*foto*)....
- ❖ Autoriteti Kontraktor (**AKBPM**) disponon të drejtën e pronësisë intelektuale mbi produktin final (pullën e kontrollit të barit me elementë sigurie) për sa i përket specifikimeve teknike dhe dizenjimit.

Oferta duhet të shoqërohet me: kampione të mallrave që kërkohen të prokurohen:

- Rulon me jo më pak se 200 pulla në rulon - 1(një) copë;
- Shirit stampimi termik - 1(një) copë  
*\*të mjaftueshme për të realizuar stampimin e plotë të rulonit me 200 pulla;*
- Rulon kartoni mbledhës për pulla - 1(një) copë;
- Rulon kartoni mbledhës për shirit printimi - 1(një) copë.

Autoriteti Kontraktor kërkon mostra të mallrave që do të prokurohen, pasi gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Mostrat e mallrave do të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe do të jenë ekskluzivisht në kontroll të Autoritetit Kontraktor.

Mostrat do të dorëzohen nga OE ofertues, në Zyrën e Protokollit të AKBPM, Kati i Parë, në adresën: Rruga e Dibrës, Nr.359/1, Tiranë, të futur në një zarf jo-transparent, të mbyllur, të vulosur dhe firmosur me emrin dhe adresën e OE ofertues dhe me shënimin: “Ofertë për furnizimin e “Blerje pulla kontrolli me elemente sigurie për barna dhe aksesorë për shtypjen e tyre”, Nr e Njoftimit, “MOS E HAPNI, ME PËRJASHTIM TË RASTEVE KUR ËSHTË I PRANISHËN KOMISIONI I VLERËSIMIT TË OFERTËS, DHE JO PARA datës: 21/2/2024, ora: 10.00”.

***Mos paraqitja e këtyre kampioneve apo mospërputhshmëria e tyre me specifikimet teknike të kërkuara në DST, në përfundim të fazës së vlerësimit teknik, përbën kusht skualifikimi.***

Për mostrat që do të dorëzohen, të plotësohet dhe të paraqitet në rrugë elektronike Lista e informacionit Konfidencial sipas shtojcës 4 të DST.

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur me qëllim që të identifikohet përmbushja e specifikimeve teknike për artikujt e kërkuar si dhe është në përputhje me pikën 1 të nenit 36 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, ku përcaktohet se: *1.Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet. Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.... [...].*

Gjithashtu ky kriter është në përputhje me pikën 2 të nenit 40 të VKM Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se: “ 2.Për mallrat që do të prokurohen, autoritetet/entet kontraktore parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë

*cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36, të LPP-së, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara.*

## **Shtojca 6**

### **FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT**

#### **Sasia e mallit që kërkohet:**

<b>Nr.</b>	<b>Përshkrimi i artikujve</b>	<b>Njësia</b>	<b>Sasia e pritshme për 24muaj</b>
1	Pulla kontrolli me elementë sigurie, dhe numër serial progresiv	copë	160,000,000
2	Shirita printimi për printer termik SQUIX ose ekuivalent	copë	10,000
3	Rulona mbledhës për pullat	copë	240,000
4	Rulona mbledhës për shirita printimi	copë	10,000

**Afatet e lëvrimit:** Sipas kërkesave të AK.

*Kontratat do të jepen brenda periudhës:* Nga momenti i lidhjes së Marrëveshjes Kuadër me OE të shpallur fitues, me afat 24 muaj nga data e nënshkrimit të MK, në bazë të kërkesave të autoritetit kontraktor deri në plotësimin e nevojave sipas marrëveshjes kuadër.

Vendi lëvrimit (destinacioni): Mallrat objekt prokurimi do të lëvrohen me mjetet e operatorit ekonomik të shpallur fitues në magazinën e autoritetit kontraktor (AKBPM), me adresë: Rruga e Dibrës, Nr.359/1, Tiranë, të përcaktuar në këto DT.

Sasitë e kërkuara për çdo kontratë do t'i jepen OE të shpallur fitues bazuar në kërkesat e Sektorit të Shpërndarjes së Barnave dhe PM për mbulimin e nevojave të sektorit me pulla kontrolli për barnat e importuara/prodhuara në vend (Neni 20 i Ligjit Nr.105/2014 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik” të ndryshuar).

#### **Garancia:**

Afati i garancisë për mallrat e lëvruara sipas kontratave të lidhura brenda MK do të jetë nga data e lëshimit të proces-verbalit të pranimit të mallrave deri në konsumin përfundimtar të tyre.

#### **Dokumentat shoqëruese të mallit:**

- *Faturë tatimore sipas përcaktimeve ligjore, për çdo sasi.*
- *Deklaratë e OE për sasinë totale të pullave të kontrollit të prodhuara, sasinë e skarciteteve, dhe dokumentacioni i asgjësimit të pullave të kontrollit skarco.*
- *Deklaratë cilësie.*
- *Deklaratë garancie.*

**Argumentimi:** Sasia dhe Grafiku i lëvrimit janë vendosur në përputhje me pikën 1 të nenit 40 të VKM Nr.285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se: *“Në procedurat e prokurimit për mallra, autoriteti/enti kontraktor parashikon sasinë e mallrave që do të lëvrojë, si dhe grafikun e lëvrimit të mallrave.”*-

## **NJËSIA E PROKURIMIT**